



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

VI

Nr. 1528/2025-W
Br. No.
Nr i Fa. 4
Br. Str.
No. Pg.
Prishtinë / Pristina

Data
Datum
Date 26.05.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-18-0069	21/05/2025	
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
Aktvendim			19/05/2025
Për	Za	To	Agjencia Kosovare e Privatizimit Rr, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë
Pranuar nga	Primio:	Recived	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	

B.M.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:014589

Datë: 21.05.2025

Numri i dokumentit: 07282929

Dosja fizike: C-IV-18-0069

Parashtruesi i kërkesës:

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore
“19 NËNTORI”, Prishtinë, PRN086**

Adresa: Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc.Bajram Miftari, me 19.05.2025, lëshon këtë:

AKTVENDIM

I. Aprovohet Raporti Përfundimtar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore “19 NËNTORI”, Prishtinë, PRN086 (Fi-689/89) dhe **lejohet** mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj NSH-je.

II. Lirohet AL nga çdo detyrë e mëtejshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.

III. Parashtruesi ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 03.08.2018, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), raportin përfundimtar të mbylljes së procesit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore “19 NËNTORI”, Prishtinë, PRN086, Regjioni i Prishtinës.

Parashtruesi i kërkesës, bashkëngjitur me raportin përfundimtar ka dorëzuar Memorandumin për Bord, të datës 12.02.2016, me të cilin AL-ja ka kërkuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, dhënien e lejes për të aplikuar për Raportin Përfundimtar. Po ashtu, është dorëzuar edhe shkresa e AL-së, e datës 12.02.2006, me të cilën është njoftuar Bordit i Drejtorëve se: “Pasi që ka ardhur në përfundimin që nuk ka asete të mbetura për të shitur, pasi që janë trajtuar të gjitha kërkesat



dhe pas komunikimit të vendimeve të gjithë parashtresve të kërkesave dhe pas konfirmimit që të gjitha vendimet janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme, me këtë rast kërkojmë autorizimin e Bordit për aprovim të raportit përfundimtar të likuidimit dhe vendimin për tu liruar nga fondet tepricë". Raportit përfundimtar i janë bashkëngjitur edhe: Llogaria e detajuar e NSH-së në likuidim; raporti përfundimtar; dhe shtojca financiare finale. Ka kërkuar nga DHPGJS-së që pas shqyrtimit të kërkesës, në pajtim me nenin 43 dhe nenin 44 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, të marr vendim me të cilin do të miratohet Raporti Përfundimtar dhe të mbyllet rasti i likuidimit të N NSH-së lëndore.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim duke përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata: Llogaria e detajuar e NSH-së në likuidim; kërkesat dhe datat e njoftimeve; ankesat në Komisionin për shqyrtimin e ankesave (me konstatimin se nuk ka pasur asnjë ankesë); ankesat-paditë në Dhomën e Posaçme; pozicioni i parave të gatshme të likuidimit; historiku përmbledhës i likuidimit; transaksionet e privatizimit dhe likuidimit; vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dt. 25.06.2018 dhe vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dt. 13.07.2017.



Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për fillimin e procedurës së Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore “19 NËNTORI”, Prishtinë, PRN086, kjo Ndërmarrje ka hyrë në proces të likuidimit me datën 01.08.2005. Pasi ka filluar procesi i likuidimit të kësaj NSH-je, Njoftimi i parë për fillimin e procesit të likuidimit, dhe për afatin e dorëzimit të kërkesave kreditore, është publikuar në muajin gusht 2005 dhe në muajin janar 2006, në gazetën Koha Ditore, në gjuhën shqipe dhe angleze. Pastaj, në gusht të vitit 2005 AKP-ja ka bërë publikimet në gjuhën serbe dhe angleze në gazetën ditore Koha Ditore, Danas dhe Blic. Po ashtu, Autoriteti i Likuidimit ka bërë edhe njoftimin me shkrim për fillimin e procesit të likuidimit të NSH-së, për disa subjekte relevante si kreditorë potencial, konform nenit 7.4 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, duke i ftuar ato që kërkesat kreditore eventuale, t’i dorëzojnë pranë AL-së. Raportit i janë bashkëngjitur dëshmitë e publikimit të këtyre njoftimeve.

Me datë 01.08.2005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë ka nxjerr vendim për fillimin e procedurës së likuidimit të Ndërmarrjes lëndore dhe për themelimin e Komisionit të Likuidimit në përbërje prej Kryesuesit dhe katër anëtarëve. Më vonë ka pasur ndryshime në përbërjen e Autoritetit të Likuidimit. Nga dëshmia “Pozicionet e parave të gatshme të likuidimit”, vërtetohet se fondi i përgjithshëm i Ndërmarrjes për parashtruesit është prej 440,824.61 €.

Në bazë të shqyrtimit të dosjes së lëndës, gjykata vlerëson se Agjencia Kosovare e Privatizimit - Autoriteti i Likuidimit, i ka ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je, andaj, e aprovon Raportin Përfundimtar të NSH-së dhe lejon mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je. Dhoma e Posaçme tërheqë vëmendjen se Autoriteti i Likuidimit mbetet përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij si Autoritet i Likuidimit, sipas nenit 46 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj, bazuar në arsyet e dhëna më sipër dhe në bazë të neneve 43 dhe 44, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore, në shumë prej 100.00 € më datë 24 gusht 2018, sipas urdhërpagesës të datës 15 shkurt 2022 dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Miftari



